

VENDIM
Nr. 162, datë 7.12.2012

**PËR DISA NDRYSHIME TË KONTRATËS SË SHITBLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
MIDIS KESH SHA DHE PVE TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 80, DATË 23.10.2012 TË
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 dhe nenit 9 të ligjit 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 4.13 germa “A”, pika 5 dhe germa “F”, pika 7, të modelit të tregut shqiptar të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 7.12.2012, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

- Palët e kësaj kontrate KESH sh.a./FPSH dhe Prodhuesve të Vegjël të Energjisë PVE, janë të licencuara nga ERE me vendimet respektive.
 - Marrëdhënia ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe Prodhuesve të Vegjël të Energjisë (PVE) është një marrëdhënie e rregulluar nga ERE.
 - Është në autoritetin e ERE-s përcaktimi i të drejtave dhe i detyrimeve respektive ndërmjet pjesëmarrësve të tregut, si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në “Modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH (FPSH) dhe Prodhuesve të Vegjël të Energjisë (PVE)”, të miratuar me vendimin nr. 80, datë 23.10.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

Teksti i ndryshimeve të kontratës:

Pas nenit 3.1, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Pavarësisht detyrimit që ka KESH për të blerë të gjithë energjinë elektrike të prodhuar nga shitësi, shitësi ka të drejtë të shesë të gjithë ose pjesë të energjisë së prodhuar subjekteve të tjera të ndryshme nga KESH, në sasi të dhe mënyrat e zgjedhura nga vetë shitësi”. Grafiku i livrimit për energjinë që do të shitet në tregun e parregulluar do të jetë në bandë sipas profilit 00:00-24:00.

Në nenin 5, pas pikës 5.2 shtohet pika 5.2/i, me këtë përmbajtje: “Kur blerësi është subjekt i ndryshëm nga KESH/FPSH impiantet prodhuese duhet të deklarojnë programet e tyre të livrimit dhe kontratat përkatëse për ditën në avancë”, si dhe planifikimin vjetor ku përcakton sasinë e energjisë elektrike që shitësi do të shesë në KESH sh.a., dhe në tregun e parregulluar të energjisë elektrike. Ky planifikim dërgohet në KESH sh.a. brenda datës 30 nëntor të vitit aktual për vitin pasardhës. Nominimi i programit përkatës do të bëhet në përpuithje me rregullat e tregut të energjisë elektrike.

Në nenin 5, pas pikës 5.3, shtohet pika 5.3/i me këtë përmbajtje: “Kur blerësi është subjekt i ndryshëm nga KESH/FPSH, ndaj impianteve prodhuese zbatohen rregullat e tregut mbi disbalancat”.

Në nenin 6, pas pikës 6.2 të shtohet pika 6.2/i, me këtë përmbajtje: “Kur prodhuesi/shitësi vendos

të operojë si në tregun e rregulluar, si në tregun e parregulluar, impiantet prodhuese duhet të jenë të pajisura me sistem telematjeje me bazë orare të integruar me sistemin e matjes së OST-së”.